



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 20 prill 2018, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Miratimin e rregullores “Mbi kriteret e ofrimit të shërbimeve të mbrojtura”. (**Vendimi nr. 68, datë 20.04.2018**)
2. “Miratimin e një ndryshimi në vendimin e AMA-s, nr. 1 datë 27.01.2016 “Për miratimin e rregullores për strukturën organizative të Autoritetit të Mediave Audiovizive” (**Vendimi nr. 69, datë 20.04.2018**)
3. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Tok Media” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “In Radio 105.7” (**Vendimi nr. 70, datë 20.04.2018**)
4. “Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Albania Studio” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të AMA-s, Nr. 45, datë 19.03.2018 “Mbi mosrinovimin e licencës së shoqërisë “Albania FM” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Albania FM” (**Vendimi nr. 71, datë 20.04.2018**)
5. “Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Vintage” sh.p.k., për subjektin audio privat vendor “Radio Vintage”. (**Vendimi nr. 72, datë 20.04.2018**)
6. “Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Capital Radio” sh.p.k., për rivendosje në afat dhe shfuqizimin e vendimit të AMA-s, nr. 90, datë 19.05.2016 “Për konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Capital Radio”, për subjektin radiofonik “Capital Radio”. (**Vendimi nr. 73, datë 20.04.2018**)
7. “Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “ABCOM” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “ABCOM” dhe për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “3N1 TV” në “Njësinë administrative Orikum”. (**Vendimi nr. 74, datë 20.04.2018**)

8. “Rinovimin e autorizimit, azhornimin dhe zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Eltion Thanasi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor APT”. **(Vendimi nr. 75, datë 20.04.2018)**
9. “Rinovimin e autorizimit dhe azhornimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Eri A&A” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor ERI A&A” **(Vendimi nr. 76, datë 20.04.2018)**
10. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Arben Xhaxhaj, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Roskovec” **(Vendimi nr. 77, datë 20.04.2018)**
11. “Zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “MRM” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Korça” **(Vendimi nr. 78, datë 20.04.2018)**
12. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Tring TV” sh.a.” **(Vendimi nr. 79, datë 20.04.2018)**
13. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në shoqërinë “Albania Byaty” sh.p.k., ndryshimin e emrit të shoqërisë në “G2 Media” sh.p.k., kalimin e kuotave nga ortaku ekzistues tek shoqëria “Gener 2” sh.p.k., ndryshimin e emërimit të subjektit audioviziv privat vendor nga “Elrodi Tv” në “A2” si dhe ndryshimin e strukturës programore nga përmbajtje transmetimi muzikor në programacion të transmetimit të lajmeve. **(Vendimi nr. 80, datë 20.04.2018)**
14. “Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Club Televizion” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Club TV”, për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së subjektit”. **(Vendimi nr. 81, datë 20.04.2018)**
15. “Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Emi Media Group” sh.p.k., duke kaluar të drejtat e licencës së subjektit audio privat vendor “Best Radio” tek shoqëria “3DS&AF Entertainment” sh.p.k. **(Vendimi nr. 82, datë 20.04.2018)**
16. “Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Ferdi Bejko, duke kaluar të drejtat e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Antipatrea Xh&A” tek subjekti person fizik Shaban Merkaj. autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Lapardha). **(Vendimi nr. 83, datë 20.04.2018)**

Tiranë, 20 prill 2018

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE